



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 564/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri, kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Faton Jakupi kandidat për kryetar komune në Kamenicë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Kamenicë, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar për kryetar të komunave të shpallura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të datës 31.10.2017 për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 02.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Faton Jakupi kandidat për kryetar komune në Kamenicë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Kamenicë, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar për kryetar të komunave të shpallura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të datës 31.10.2017 për Zgjedhjet Lokale 2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 01.11.2017 në ora 14:30, ka pranuar një ankesë nga Faton Jakupi kandidat për kryetar komune në Kamenicë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Kamenicë, në të cilën thekson se në komunën e Kamenicës gjatë procesit të numërimit të votave në klasën 1024D/01R, 1024D/02R, 1024D/03R gjatë numërimit të votave, votat e Faton Jakupit janë numëruar si votë e Amir Canajt kandidat i AKR-së në Kamenicë. Parashtruesi i ankesës thekson se gjatë leximit të votave qëllimisht vota për Faton Jakupin janë regjistruar për Amir Canaj nga komisionerë të pandërgjegjshëm të klasave të lartcekura.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimor, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar ato pretendime edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, mirëpo i njëjti me asnjë provë apo dëshmi nuk ka argumentuar për parregullsitë e pretenduara në ankesë.

Parashtrimet në ankesë nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotimet e sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për ankuesin .

Paneli vlerëso se pretendimet në ankesë nuk janë te bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pa argumentuar me fakte dhe si e tillë është e pabazuar .

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL Anr.564/2017 më datën 02.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.